



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1470/1 Prot.

Tiranë, më 27 / 09 / 2019

V E N D I M

Nr. 128, Datë 27 / 09 / 2019

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 40, datë 26.04.2019, e bërë nga Shoqata “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian” kundër Bashkisë Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës¹, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Komuniteti rom dhe egjiptian, banorë të lagjes “Liria” në qytetin e Shkodrës, prej vitesh ndeshen me një situatë shumë të keqe sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, mungesës së kanalizimeve dhe mungesës së ndriçimit. Lagjja “Liria” furnizohet pjesërisht me ujë, por duke qenë se lagjja ndodhet e vendosur në një lartësi të caktuar, furnizimi nuk realizohet i plotë në të gjitha familjet. Mungesa e kanalizimeve është një problem shqetësues dhe emergjent, pasi ujërat e zeza kalojnë përmes lagjes dhe kjo mund të sjellë dhe përhapje të epidemive të ndryshme tek banorët e lagjes. Problematikë tjetër është dhe mungesa e ndriçimit në lagje, i cili është një shërbim që ofrohet në të gjitha lagjet e Shkodrës dhe vetëm në lagjen “Liria” nuk është ndërhyrë për sigurimin e këtij shërbimi publik”.*

Referuar Vendimit nr. 3916, datë 17.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, Shoqata “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian” është regjistruar si person juridik dhe ka në fokus të veprimtarisë së saj mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Egjiptian dhe Rom në Shqipëri, gjë që e legjitimon atë “*locus standi*” për të paraqitur ankesë në emër të Komunitetit Egjiptian dhe Rom për çdo pretendim për diskriminim për shkak të racës.

¹ Ankesa është paraqitur nga K.Sh, në pozicionin si kryetar i shoqatës “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e problematikave të ngritura.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 40, datë 26.04.2019, të bërë nga Shoqata “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian” u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 644/1, datë 03.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Shkodër për ankesën e bërë nga Shoqata “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian” si dhe ka kërkuar parashtrime dhe dokumentacion provues, lidhur me pretendimet për diskriminim të banorëve që i përkasin komunitetit egjiptian, në lagjen “Liria”, si dhe masat e marra nga Bashkia Shkodër për rregullimin e situatës.
- Me shkresën nr. 644/2, datë 10.06.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar përsëri nga Bashkia Shkodër, informacionin lidhur me pretendimet për diskriminim të Shoqatës “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian”.

Me shkresën nr. 10078/1, datë 18.06.2019, Bashkia Shkodër në mes të tjerash informoi se: “Në vitin 2017 në lagjen “Liria” në zbatim të projektit “Fuqizimi Ekonomik dhe Social për Romët dhe Egjiptianët-një shtysë për përfshirjen sociale” (FESRE) financuar nga Bashkimi Evropian e në zbatim nga UNDP, është realizuar investimi me objekt “Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ngritja e çezmave publike” (me vlerë prej 9.944.168 lekë). Ky investim bëri të mundur, për herë të parë, sigurimin e ujit të pijshëm për rreth 150 banorë dhe administrimi i KUZ e KUB të cilat derdreshin direkt në lumin Buna. Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar disa takime me Fondin e Zhvillimit në lidhje me studimin e fizibilitetit dhe VNM-së: “Liqeni i Shkodrës, fshatrat Shirokë dhe Zogaj, sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve”. Një pjesë e madhe e diskutimeve është përqëndruar në zhvillimin e infrastrukturës së re të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Bashkia Shkodër ka kërkuar që studimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të trajtojë njëherë e përgjithmonë situatën në këtë komunitet. Ndësa përsa i përket furnizimit me ujë të lagjes Liria, Shirokë dhe Zogaj, kërkon një kombinim të infrastrukturës së re dhe rehabilitim të pajisjeve. Fondet për realizimin e këtyre investimeve janë të pamundura të mbulohen nga Bashkia Shkodër. Në buxhetin e vitit 2019 është parashikuar investimi në infrastrukturën rrugore i shtrirë në lagjen “Liria” me objekt “Rikualifikimi urban i hyrjes së qytetit dhe parkut për pushuesit”. Për shkak të VKM-së nr. 284, datë 10.05.2019 “Për pezullimin e përkohshëm të fillimit të procedurave të prokurimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet kontraktore në varësi të tyre për periudhën 01 deri 30 qershor 2019” ky objekt nuk është arritur që të prokurohet. Bashkia Shkodër ka investuar në këtë zonë duke siguruar ndriçimin e rrugës kryesore në hyrje të qytetit ku përfshihet lagjja Liria, rruga e Kalasë që kalon përmes lagjes dhe shkollës “Liria”. Në të ardhmen do të shikohet mundësia për ndriçimin e rrugicave të vogëla të kësaj lagjeje, pasi edhe në lagjet e tjera të qytetit Shkodër paraqitet e njëjta situatë”.

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Shkodër, Kryetari i Shoqatës, K.Sh në datë 21.06.2019 në mes të tjerash ka deklaruar² se: “Në vitin 2017 në lagjen “Liria” nuk është bërë asnjë investim lidhur me kanalizimet, pasi problematika vazhdon të jetë prezent në lagje. Përsa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, është e vërtetë që janë bërë investime por uji i pijshëm, nuk u sigurohet të gjitha familjeve të lagjes për shkak se një pjesë e madhe e banesave janë të vendosura në një lartësi të caktuar dhe për këtë arsye nevojiten investime të tjera për sigurimin e ujit të pijshëm në të gjitha familjet. Përsa i përket investimeve të realizuara ose jo nga Bashkia Shkodër në zonën Shirokë-Zogaj dhe ndriçimi i rrugës kryesore në hyrje të qytetit, ankuesi deklaroi se nuk është objekt i ankesës së tyre, objekt i ankesës së tyre është, mungesa e ofrimit të shërbimeve publike dhe ndriçimit të rrugicave në lagjen “Liria””.

Me shkresën nr. 560/2, datë 14.06.2019, Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime Shkodër” sh.a në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Komuniteti Rom dhe Egjiptian banon në dy anët e urës së Bunës. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a është shumë e interesuar për përmirësimin e kushteve të jetesës si për furnizimin me ujë të pijshëm ashtu dhe për kanalizimet e ujërave të ndotura urbane. Konkretisht për banorët e kësaj lagjeje që ndodhen në anën e djathtë të rrugës së Shirokës, Ndërrmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Bashkia Shkodër kanë ndërtuar me fondin

² Referuar procesverbalit datë 21.06.2019 të mbajtur në mjediset e Zyrës Rajonale Shkodër të KMD-së.

e një shoqate një kolektor të ujërave të ndotura urbane dhe një gropë septike poshtë në rrugë. Përsa i përket furnizimit me ujë, kjo pjesë furnizohet nga një pus i vendosur në territorin e fshatit të Paqes që është pronë e Kishës. Theksohet që për këtë pjesë të banesave, KfV ka përfunduar studimin e fizibilitetit dhe shumë shpejt do të kthehet në projekt për zgjidhje. Për pjesën tjetër të kësaj lagje që kalon paralel me rrugën nacionale, furnizohet pjesërisht me ujë të pijshëm, ndërsa janë në gjendje shumë të keqe përsa i përket rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane. Edhe kjo zonë është në fazën e studimit të fizibilitetit nga KfV dhe shpresojmë se shumë shpejt do të marrin një zgjidhje përfundimtare”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 40, datë 26.04.2019, Komisioneri me shkresën nr. 644/4, datë 25.06.2019 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 04.07.2019, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Kopje të projekteve të realizuara, lidhur me investimet në kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe për sigurimin e ujit të pijshëm në lagjen “Liria” nga viti 2016 e në vijim.
 - Kopje të projekteve të parashikuara, lidhur me investimet në kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe për sigurimin e ujit të pijshëm në lagjen “Liria” për vitet 2019-2022.

Në seancë nuk u paraqitën asnjëra nga palët në proces, megjithëse Bashkia Shkodër ka marrë njoftim në lidhje me shkresën e mësipërme, në datë 27.06.2019, sipas lajmërimit nga Posta Shqiptare RR 604 594 751 AA. Rezulton gjithashtu që dhe pala ankuese ka marrë njoftimin po në datë 27.06.2019, sipas lajmërimit nga Posta Shqiptare RR 607 931 909 AA.

- Në vijim të procedurës për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 644/5, datë 24.07.2019 ka kërkuar nga Bashkia Shkodër dhe Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Shkodër, informacionin shtesë si më poshtë:
 - Kopje të projekteve të realizuara, për sigurimin e ujit të pijshëm, për investimet në kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe sigurimin e ndriçimit në rrugica nga viti 2016 e në vijim, në lagjen “Liria”.
 - Kopje të projekteve të parashikuara, për sigurimin e ujit të pijshëm, për investimet në kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe sigurimin e ndriçimit në rrugica për vitet 2019-2022, në lagjen “Liria”.
 - Dokumentin që Bashkia Shkodër i ka drejtuar FSHZH, në të cilën i ka kërkuar që studimi i fizibilitetit dhe VNM-së: “*Liçeni i Shkodrës, fshatrat Shirokë dhe Zogaj, sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe përmirësimi i mbejtjeve*”, duhet të ishte gjithëpërfshirës dhe të trajtonte njëherë e përgjithmonë situatën në komunitetin e lagjes “Liria”.
 - Studimet e fizibilitetit të realizuara për këtë lagje nga KfV-ja dhe parashikimin se kur do të realizohet investimi.

Me shkresën nr. 560/3, datë 13.08.2019, Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime Shkodër” sh.a në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në lagjen “Liria” janë bërë disa ndërhyrje për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura, por nevoja për një investim afatgjatë në këtë lagje është shumë i rëndësishëm për të siguruar një shërbim të vazhdueshëm dhe cilësor. Shoqëria UK Shkodër mbulon një territor shumë të gjerë nga Thethi deri në Velipojë, dhe problematikat e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është prezente në shumë pjesë të territorit, duke përfshirë dhe komunitetin e lagjes “Liria”, por mundësitë financiare të UKSH janë të limituara në këtë drejtim. Lidhur me projektet konkrete të realizuara ose në plan për tu realizuar, UKSH informon se, në zonën e lagjes “Liria” janë bërë riparime të pjesshme, por projekti që është marrë përsipër nga KFV nuk është dorëzuar akoma, prandaj aktualisht nuk ka një projekt konkret për këtë zonë, qoftë për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për largimin e ujërave të ndotura”.*

Lidhur me informacionin e kërkuar, Bashkia Shkodër ka marrë njoftim, në datë 29.07.2019, sipas lajmërimit nga Posta Shqiptare RR 600 175 414 AA, por nuk ka kthyer përgjigje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues ose të pabarabartë.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga të dyja palët në proces që:

Së pari, megjithë investimet e ndërmarrë në vitin 2017, përsëri një pjesë e familjeve, banorë të lagjes “Liria” nuk furnizohen me ujë të pijshëm prej shumë vitesh dhe ende nuk është gjetur zgjidhja e duhur për furnizimin e këtyre banorëve, fakt ky i pranuar dhe nga Bashkia Shkodër kur shprehet se furnizimi me ujë të pijshëm të lagjes kërkon një kombinim të infrastrukturës së re dhe rehabilitimit të pajisjeve.

Së dyti, rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në gjendje shumë të keqe dhe ka nevojë për ndërhyrje të specializuara nga ana e organeve përgjegjëse, fakt ky i pranuar dhe nga UK Shkodër kur pohon se zona është në fazën e studimit të fizibilitetit për një zgjidhje përfundimtare.

Së treti, ka mungesë në ndriçimin e rrugicave të lagjes, fakt ky i pranuar dhe nga Bashkia Shkodër kur shprehet se, do të shikohet mundësia për ndriçimin e rrugicave të vogla.

Referuar nenit 23, pikat 1, 2 dhe 5 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në të cilin përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. 5. Ndriçimin e mjediseve publike.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se Bashkia Shkodër, nëpërmjet Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” sh.a, është autoriteti përgjegjës për furnizimin me ujë të

pijshëm dhe trajtimin e ujërave të ndotura të familjeve, banorë të lagjes “Liria”, dhe nuk mund të justifikojë mosveprimin e saj, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe të trajtimit të ujërave të ndotura të banorëve të lagjes “Liria”, me mungesën e fondeve.

Banorët e kësaj lagjeje, janë komunitet egjiptian dhe rom dhe jetojnë prej vitesh në kushte tërësisht të papërshtatshme jetese: me mungesë të ujit të pijshëm dhe me mosfunksionim të kanalizimeve të ujërave të zeza, gjë që çon në kushtet e trajtimit johuman të këtij komuniteti.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Shkodër. Pra, në këtë rast Bashkia, duhet të provonte se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme se banorët e lagjeve të tjera që nuk banojnë nga anëtarë të komunitetit egjiptian dhe rom.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Po ashtu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër, dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate jetike për banorët e lagjes “Liria”.

Në këto kushte, referuar informacionit të administruar, Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër, nuk vuri në dispozicion të KMD-së, asnjë dokumentacion mbi projektet e realizuara dhe projektet e parashikuara, për sigurimin e ujit të pijshëm, për investimet në kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza, si dhe sigurimin e ndriçimit në rrugica, në lagjen “Liria”.

Bashkia Shkodër, pavarësisht zbatimit të projektit me objekt “Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ngritja e çezmave publike” të realizuar në vitin 2017, me financim të Bashkimit Evropian dhe të zbatuar nga UNDP, ka dështuar të sigurojë furnizimin efektivisht me ujë të pijshëm, trajtimin e ujërave të ndotura dhe ndriçimin e rrugicave, të të gjithë banorëve të lagjes “Liria”, si dhe të informojë Komisionerin, lidhur me projektet e parashikuara prej saj, si zgjidhje efektive të kësaj problematike. Pretendimi i Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë UK Shkodër lidhur me studimet që po bëhen nga Fondi i Zhvillimit dhe KfV mbeten më së shumti të karakterit deklarativ sesa të dokumentuar dhe argumentuar duke saktësuar data apo periudha konkrete për realizimin e tyre.

Në analizë të sa mësipër, mungesa e ujit të pijshëm për një pjesë të banorëve, e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndriçimit të rrugicave, është fakt i njohur prej kohësh, për të cilat Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër, nuk kanë marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje. Mospërmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, ka vendosur banorët e komunitetit rom dhe egjiptian, që banojnë në këtë zonë, në pozita të pafavorshme dhe Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër kanë dështuar në marrjen e masave të duhura për përmirësimin e kushteve të jetesës të këtyre banorëve.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2³ të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponohet nga hetimi, Komisioneri vlerëson se banorët e lagjes “Liria” mbartin shkakun e pretenduar, atë të racës. Shoqata “Të drejtat e Komunitetit Egjiptian”, pretendon se banorët e lagjes “Liria” janë trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e Bashkisë Shkodër, përmes mosveprimit të saj për të zgjidhur dhe përmirësuar situatën e tyre, pikërisht për shkak të racës.

Raca, është shkak për të cilin Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit

³ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim”.

të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë UK Shkodër, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga ankuesi, sipas parashikimeve të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të tyre.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër⁴, ishin në dijeni të problematikave të ngritura nga ankuesit dhe se kishin dështuar deri më tani të ndërmerinin masa për përmirësimin apo rregullimin e situatës, e cila pranohet edhe prej tyre.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta⁵ si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese⁶. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjtetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjteti i njeriut, si një garanci themelore.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive

⁴ Referuar shkresës nr. 10078/1, datë 18.06.2019 të Bashkisë Shkodër dhe nr. 560/2, datë 14.06.2019 të UK Shkodër, drejtuar Komisionerit.

⁵ Neni 18 i Kushtetutës ka sanksionuar se: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

⁶ Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.

themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë⁷, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *“...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...”*.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm⁸ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

GJEDNJ-ja në disa raste ka konkluduar se kushtet e mjerueshme të jetesës mund të konsiderohen si trajtim çnjerëzor dhe degradues⁹. Gjykata është shprehur se mungesa e aksesit për ujë të pijshëm dhe higjenë çon në trajtim çnjerëzor dhe degradues të njeriut.

Referuar rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për ujë të pijshëm të pastër dhe të sigurt si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gëzimin e plotë të jetës dhe të të gjitha të drejtave të njeriut, theksohet se uji i pastër është esencial në realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Kjo rezolutë shton tryshinë mbi përgjegjësinë politike të shteteve për t'u garantuar qytetarëve të drejtën elementare për ujë të pijshëm.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mungesa e kanalizimeve, nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë UK Shkodër, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situatë për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përmbushin detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Referuar nenit 23, pikat 1, 2 dhe 5 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: - prodhimin, trajtimin,

⁷ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

⁸ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁹ Çështja “Neshkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë” dhe “Jordan Petrov kundër Bullgarisë” dhe “Halil Adem kundër Bullgarisë”.

transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; - mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; - ndriçimin e mjediseve publike.

Nuk mund të pretendohet se është përmbushur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm apo ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza vetëm për faktin se është bërë një investim i pjesshëm në vitin 2017, që ka siguruar ujë të pijshëm për rreth 150 banorë dhe administrimin e ujërave të zeza që derdeshin në lumin Buna. Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e rrjetit të furnizimit me ujë, por aksesin e qytetarëve në ujin e pijshëm; në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si për përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak.

Kuadri ligjor¹⁰ ka mirëpërcaktuar se është detyrë e përgjegjësi e UK-së (që është në varësi të pushtetit vendor) të sigurojë furnizimin me ujë të pijshëm dhe të shëndetshëm dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Rregullorja “Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetës Kanalizimeve sh.a”, e miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar marrëdhënien ligjore ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UK sh.a, që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, pra Pushteteve Vendore në përbërje të zonës së shërbimit.

Nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, rregullorja synon, ndër të tjera, edhe sigurimin e një furnizimi me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi.

Pika 1.2 e kësaj rregulloreje ka përcaktuar se, në përputhje me detyrimin ligjor për të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe konsumatorëve të tjerë, si dhe largimin e kontrolluar dhe me rregull të ujërave të ndotura, Bashkia ngarkon për funksionim dhe mirëmbajtje një shoqëri publike të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit për këto shërbime. Bashkitë që posedojnë 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionerëve realizojnë vendimmarrjet e rëndësishme për UK sh.a, përcaktojnë natyrën dhe qëllimin e ndërmarrjes si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj. UK sh.a përfaqëson institucionin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të Bashkisë që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimin me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonën e shërbimit. Objekti i UK sh.a në zonën e shërbimit për ujin e pijshëm është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitja e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm;

Ndërsa për shërbimet e kanalizimeve të ujërave të ndotura, objekt i saj do të jetë:

- Largimi i kontrolluar i ujërave të ndotura që prodhohen në zonën e shërbimit nga konsumatorët ;

¹⁰ VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit rregullues “Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetës kanalizime sh.a”.

- Mirëmbajtja e elementëve përbërës të sistemit të kanalizimit;

Lidhur me sa mësipër, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i KB (CESCR), kërkon që shtetet të angazhohen për ngritjen e sistemeve për shpërndarjen e ujit, që shmangin përjashtimin e grupeve të caktuara të popullsisë, e veçanërisht ato grupe të mbrojtura nga parimet e mosdiskriminimit.

Sipas CESCR-së: *“Shtetet palë duhet të ndërmarrin hapa për të eliminuar “de facto” diskriminimin për shkaqet e ndaluara në ligj, ku individët apo grupet e personave nuk duhet të jenë të privuara nga mjetet apo të drejtat për të siguruar të drejtën e ujit. Shtetet palë duhet të sigurojnë që, shpërndarja e burimeve të ujit dhe investimet për ujin të lehtësojnë aksesin tek uji për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Duke respektuar të drejtën për ujë, Shtetet palë kanë detyrimin e posaçëm për t’u siguruar atyre që nuk kanë, ujin e pijshëm si dhe për të parandaluar çdo diskriminim për shkaqet e ndaluara dhe të njohura në të drejtën ndërkombëtare lidhur me sigurimin e ujit të pijshëm dhe të shërbimeve të ujit”.*

Lidhur me sa mësipër, banorëve të lagjes “Liria” i është mohuar e drejta e aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm, një e drejtë e domosdoshme dhe jetike.

Bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe faktin që gjendja pranohet nga të dyja palët në proces, konstatohet që gjendja e këtyre banorëve vijon të mbetet e pa zgjidhur.

Nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë UK Shkodër, nuk është paraqitur asnjë provë apo fakt i dokumentuar, që do të justifikojë mosmarrjen e masave efektive për sigurimin e ujit të pijshëm, trajtimin e ujërave të ndotura dhe ndriçimin e rrugicave në lagjen “Liria”.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Bashkisë Shkodër, në dëm të ankuesve, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese, pikërisht për shkak të racës.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, ka përcaktuar se, diskriminimi i drejtëpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7/1¹¹, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesit, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë “Ujësjellës – Kanalizime Shkodër” sh.a, trajtim i cili ka lidhje të drejtëpërdrejtë, me racën.

¹¹Në nenin 7/1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7/1, nenin 12, nenin 21/1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, të banorëve të lagjes “Liria”, nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër” SH.A.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër” SH.A.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Bashkia Shkodër dhe Shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër” SH.A, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

ROBERT GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA